

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8284  
E martë, prill 2026  
Çmimi 0.50 €

## 16 - TË MILIONËT E ALBINIT!

FAQE 6



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KURTI ME OFERTË PËR LDK-në, ABDIXHIKU E REFUZON, VENDI DREJT ZGJEDHJEVE

FAQE 4-5



Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, dhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, kanë dështuar të arrijnë marrëveshje

të hënën për zgjedhjen e presidentit të ri. Kurti i bëri një ofertë Abdixhikut për bashkëqeverisje, duke i ofruar postin e zëvendëskryeministrit

dhe katër ministri, me kusht që posti i presidentit t'i takojë LV-së, por lideri i LDK-së e refuzoi këtë ofertë, duke theksuar se nuk do të takohet më me Kurtin

### AKTUALE



**FATI I ARMËPUSHIMIT DHE BISEDIMEVE PËR PAQE MBETET I PAQARTË TEKSA SHBA-ja KAP NJË ANIJE IRANIANE** F. 2

**KOSOVA E SHPALL ORGANIZATË TERRORISTE GARDËN REVOLUCIONARE ISLAMIKE TË IRANIT** F. 7

**AAK-ja KËRKON QË PENSIONET E VETERANËVE TË UÇK-së TË JENË SA PAGA MINIMALE** F. 6

### EKONOMI



**QEVERIA KURTI MIRATON 23 VENDIME VETËM NË NJË MBLEDHJE** F. 8

**MINISTRJA KUSARI-LILA PARAQET PAKETË MASASH PËR ZHVILLIM EKONOMIK, TREGTI DHE INOVACION** F. 8

### SPORT



**KOMBËTARJA E KOSOVËS U19 PËR VAJZA NGJITET NË LIGËN A** F. 11



**BALLKANI PERËNDIMOR RREZIKON TË HUMBASË MBI 700 MILIONË EURO NGA PLANI I RRRITJES** F. 3



**KËTA NUK JANË NORMALË** F. 7

Imer MUSHKOLAJ

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# FATI I ARMËPUSHIMIT DHE BISEDIMEVE PËR PAQE MBETET I PAQARTË TEKSA SHBA-JA KAP NJË ANIJE IRANIANE

UASHINGTON, 20 PRILL - Forcat e Shteteve të Bashkuara e kanë kapur një anije me flamur iranian në Gjirin e Omanit pasi kishin shtënë ndaj saj fillimisht, sepse ajo po përpiquej ta shmangte bllokadën detare amerikane, njoftuan të dielën vonë presidenti Donald Trump dhe Pentagoni, duke e nxitur Iranin të kërcënojë me hakmarrje.

Ndërkohë, pasiguria lidhur me një rund të dytë të mundshëm të bisedimeve ballë për ballë mes delegacioneve amerikane dhe iraniane në Islamabad të Pakistanit, po vazhdon, pasi mediat shtetërore iraniane thanë se Teherani nuk do të dërgojë ekipin e tij për takimin e së hënës.

E gjithë kjo po ndodh ndërsa armëpushimi 10-ditor, për të cilin u pajtuan Uashingtoni dhe Teherani, do të skadojë të mërkurën.

Trump ka kërcënuar me sulme të reja ndaj “të gjitha” centraleve elektrike dhe urave iraniane, nëse nuk arrihet marrëveshja.

Agjencia zyrtare iraniane e lajmeve, IRNA raportoi se Teherani e ka hedhur poshtë rundin e ri të bisedimeve për paqe, vetëm disa orë pasi Trump tha se përfaqësuesit e tij do të mbërrinin në Islamabad të hënën për negociata të ndërmjetësuar nga Pakistani. “Irani deklaroi se mungesa e tij në rundin e dytë të bisedimeve buron nga ajo që e quajti kërkesa të tepruara të Uashingtonit, pritshmëri jorealiste, ndryshime të

vazhdueshme të qëndrimeve, kundërshti të përsëritura dhe bllokada e vazhdueshme detare, të cilën e cilëson si shkelje të armëpushimit”, shkroi IRNA.

Qeveria e Iranit nuk ka bërë deklaratë zyrtare.

Negociatori kryesor i Teheranit, kryetari i Parlamentit, Mohammad Baqer Qalibaf, ka dhënë deklarata që tregojnë “përparim”, por njëkohësisht edhe “dallime të mëdha” lidhur me bisedimet. Ai, megjithatë, nuk ka folu drejtpërdrejt për bisedimet e të hënës.

Pasiguri ka edhe për përbërjen e delegacionit amerikan. Shtëpia e Bardhë tha se nënpresidenti JD Vance do të drejtonte rundin e ri të bisedimeve, së bashku me të dërguarin e Trumpit, Steve Witkoff, dhe dhëndrin Jared Kushner.

Megjithatë, Trump u tha ABC News dhe MS Now se Vance nuk do të shkojë, duke përmendur shqetësime për sigurinë. “Vetëm për arsye sigurie”, tha Trump për ABC News. “JD është i shkëlqyeshëm”.

Ai sugjeroi gjithashtu se bisedimet mund të fillojnë një ditë më vonë, të martën e 21 prillit.

Një reporter i Fox News tha se Trump i kishte thënë se, nëse Irani nuk nënshkruan marrëveshje, “i gjithë vendi do të shkatërrohet”.

Kryeministri pakistanez, Shehbaz Sharif, rikonfirmoi të dielën gatishmërinë e tij për të pritur rundin e ardhshëm të bisedimeve. “Pakistani mbetet plotësisht i përkushtuar ndaj



rolit të tij si një lehtësues i ndershëm dhe i singjertë i paqes së qëndrueshme dhe stabilitetit rajonal”, tha ai.

## Kapja e anijes iraniane

Ndërkohë, në ujërat përreth Iranit, tensionet u rritën edhe më tej pasi forcat amerikane hapën zjarr dhe e kapën një anije mallrash me flamur iranian, e cila po përpiquej ta shmangte bllokadën detare amerikane.

Vetë bllokada është një nga pengesat për vazhdimin e bisedimeve, të paktën sipas Iranit. Teherani ka thënë se nuk do të marrë pjesë në bisedime për aq kohë sa bllokada është në fuqi, ndërsa Trump ka deklaruar se ajo nuk do të hiqet derisa të nënshkruhet një marrëveshje për paqe.

Trump shkroi në Truth Social se pasi anija iraniane, Touska, shpërfilli paralajmërimet për t’u

ndalur, shkatërruesi amerikan USS Spruance “i ndaloi menjëherë duke shpuar një vrimë në dhomën e motorit”.

Anija “u përpoq ta kalonte bllokadën tonë detare dhe e pësoi”. “Tani për tani, marinsat amerikanë e kanë në kontroll anijen... dhe po shohin se çfarë ka në bord”, shkroi Trump.

Komanda Qendrore e SHBA-së (CENTCOM) tha se “forcat amerikane që operojnë në Detin Arabik zbatuan masat e bllokadës detare ndaj një anijeje mallrash me flamur iranian që po përpiquej të lundronte drejt një porti iranian”. “Forcat amerikane dhanë paralajmërimet të shumta dhe e njoftuan anijen se po shkelte bllokadën amerikane”, shtoi ajo.

Komanda e përbashkët ushtarake e Iranit pretendoi se të shtënat shkelën armëpushimin dhe kërcënoi se do të përgjigjej dhe hakmerrej

“së shpejti” ndaj “piraterisë së armatosur”, sipas mediave shtetërore.

Ajo tha se anija po udhëtonte nga Kina drejt Iranit kur u godit dhe pretendoi se forcat iraniane sulmuan me dronë disa anije ushtarake amerikane. Ky pretendim nuk mund të verifikohet në mënyrë të pavarur.

Më herët gjatë javës, kishte shpresa se Ngushtica e Hormuzit, e cila zakonisht përbën rreth një të pestën e tregtisë globale të naftës, do të hapej pas më shumë se një muaji mbylljeje, pasi Teherani njoftoi se ishte hapur për trafikun tregtar detar.

Megjithatë, forcat iraniane qëlluan ndaj të paktën tri anijeve civile, dy prej të cilave raportohet se ishin indiane dhe një me flamur francez, dhe njoftuan mbylljen e serishme të ngushticës.

## BE-ja BËN “PAQE” ME HUNGARINË, KOMISIONI EVROPIAN FLET PËR BISEDIME JASHTËZAKONISHT KONSTRUKTIVE ME “QEVERINË E RE”



BUDAPEST, 20 PRILL - BE-ja i vlerëson si “jashtëzakonisht konstruktive” bisedimet me atë që pritet të jetë qeveria e re hungareze.

Komisioni Evropian bëri një përditësim të shkurtër të situatës pas kontakteve këtë hungareze me ekzekutivin e ardhshëm hungarez, dhe një zëdhënës i tij Olof Gill, foli për “tone shumë pozitive”.

Kjo ishte “një pikënisje shumë e dobishme për punën që duhet bërë, sidomos sa i alokimit të fondeve të ngrira, lëvizje kjo që është në dobi të popullit hungarez”, ishte komenti i tij. Kur u pyet lidhur

me qëndrimin e qeverisë së re të Hungarisë në raport me Ukrainën, Gill refuzoi të japë më shumë detaje, por përcolli një sugjerim të qartë duke thënë: “Çështja këtu është që ne po diskutojmë me këtë qeveri me qëllimin të avancohet në një seri çështjesh të cilat kanë qenë të bllokuar prej një kohe të gjatë”.

Fituesi i zgjedhjeve të përgjithshme, Peter Magyar, lider i partisë Tisza i cili arriti të përmbyste Viktor Orbanin pas 16 vitesh në pushtet, ka shfaqur një qëndrim pro-evropian dhe konstruktiv duke i bërë të qarta synimet e tij për riparimin e

marrëdhënieve me Brukselin dhe forcimin e sundimit të ligjit. Magyar premton veprime në përputhje me vlerat demokratike perëndimore dhe kërkon fundin e përplasjes me institucionet e BE-së, megjithëse synon nga ana tjetër të ruajë qëndrime të pavarura në politikën e jashtme mbi çështje si anëtarësimi i shpejtë i Ukrainës në BE.

Në tërësi, sipas analistëve, Magyar ka premtuar të largohet nga narrativa e Orbanit se “Brukseli është i keq”, duke u fokusuar te dialogu dhe gjetja e kompromisit, dhe jo te konflikti.

## Haxhiu pranon raportin e BE-së për zgjedhjet e 2025-s

PRISHTINË, 20 PRILL - Ushtruesja e detyrës së presidentit, Albulena Haxhiu, ka pritur të hënën në takim shefen në detyrë të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, Eva Palatova. Kjo e fundit, gjatë takimit, ia ka dorëzuar Haxhiut raportin e Misionit të Ekspertëve të Bashkimit Evropian për zgjedhjet

parlamentare të vitit 2025 si dhe raportin lidhur me misionin vlerësues për zgjedhjet komunale të mbajtura në tetor dhe nëntor 2025. "U pajtuam që këto procese zgjedhore ishin dëshmi e pjekurisë demokratike të Kosovës. E sigurova znj. Eva Palatova se gjetjet dhe rekomandimet e

paraqitura në raportet vlerësuese do të shqyrtohen me kujdes dhe do të adresohen me përgjegjësi, në funksion të forcimit të mëtejshëm të proceseve zgjedhore në Kosovë. Kosova mbetet e përkushtuar ndaj standardeve demokratike, sundimit të ligjit dhe rrugës së saj evropiane", ka shkruar Haxhiu në "Facebook".



## BALLKANI PERËNDIMOR RREZIKON TË HUMBASË MBI 700 MILIONË EURO NGA PLANI I RITJES

PRISHTINË, 20 PRILL - Komisionarja evropiane për Zgjerim, Marta Kos, ka paralajmëruar me shkrim gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor se rrezikojnë që deri në mesin e këtij viti të humbasin kolektivisht mbi 700 milionë euro nga Planin e Rritjes për shkak të moszbatimit të reformave, mëson Radio Evropa e Lirë (REL) nga burime në Komisionin Evropian (KE). Sipas informacioneve jozyrtare, komisionarja Kos e ka dërguar këtë letër më 17 prill në të gjitha kryeqytetet e rajonit. Burimet e REL-it kanë konfirmuar se me këtë letër komisionarja Kos u ka kërkuar të gjithave vendeve t'i përshpejtojnë reformat e parashikuara në Planin e Rritjes, në mënyrë që ta shfrytëzojnë plotësisht potencialin e kësaj pakoje financiare. Në fakt, mjetet financiare nga

Planin e Rritjes janë të kufizuara në kohë. Për çdo hap reformues është paraparë një afat përfundimtar për zbatim dhe është ndarë një shumë e caktuar parash. KE-ja ka paraparë edhe të ashtuquajturën "periudhë grejs", e cila mundëson shtyrjen e zbatimit për një periudhë të caktuar kohore. Për hapat që duhej të përmbusheshin në mesin e vitit 2025, afati përfundimtar skadon më 30 qershor të këtij viti, ndërsa për hapat që duhej të realizoheshin në fund të vitit 2024, ky afat përfundon gjatë vitit 2026. "Nëse nuk përmbushen, partnerët rrezikojnë të humbasin kolektivisht mbi 700 milionë euro", konfirmoi për REL një zyrtar i KE-së. Këstin e parë ose disa mjete nga Planin e Rritjes i kanë marrë pesë shtete të rajonit, me përjashtim të Bosnjë-Hercegovinës, e cila është



vonuar me miratimin e agjendës reformuese. Fundi i qershorit të këtij viti përbën momentin kur secili vend hyn në të ashtuquajturin moment të humbjes së përhershme nëse nuk i përmbush reformat e dakorduara më herët. Sipas burimeve në Bruksel, humbjet

e mundshme sipas shteteve, në rast se nuk ndërmerren të gjitha reformat, janë si vijon: Kosova: 68.8 milionë euro; Shqipëria: 67.7 milionë euro; Bosnja dhe Hercegovina: 373.9 milionë euro; Mali i Zi: 15.1 milionë euro; Maqedonia e Veriut: 49.2 milionë euro; Serbia: ndërmjet 108.7 dhe

135.9 milionë euro. Bazuar në shumën maksimale, në total mund të humben 710.6 milionë euro, që përfaqëson 11.84 për qind të financimit të përgjithshëm nga Planin e Rritjes.

Pakoja e BE-së për Ballkanin Perëndimor - për periudhën 2024-2027 - është në vlerë të 6 miliardë eurove. Nëse analizohen ndarjet buxhetore, Kosovës i takojnë rreth 882 milionë euro - 253 milionë si grante dhe 629 milionë euro në formë të kredisë - që do të thotë se përfiton më së shumti fonde në rajon për kokë banori. Më 16 prill Kosova mori 61.8 milionë euro parafinancim, pasi vendi dorëzoi dokumentet e nevojshme në KE dhe ratifikoi marrëveshjet e lidhura me këtë plan. Ky plan, ndër të tjera, synon t'i dyfishojë ekonomitë e këtyre vendeve gjatë dhjetë viteve të ardhshme.

## KURTI: KOSOVA APLIKOI PËR ANËTARËSIM NË BE NË MESIN E DHJETORIT TË VITIT 2022, ENDE NUK SHQYRTOHET NGA KËSHILLI



PRISHTINË, 20 PRILL - Kosova ka aplikuar për anëtarësim në Bashkimin Evropian në mesin e dhjetorit të vitit 2022. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se më 15 prill të këtij viti u bënë 40 muaj që aplikimi ka mbetur i pashqyrtuar nga Këshilli. Kurti ka shkruar në "Facebook" se Kosova është demokracia më e avancuar e rajonit, me mesataren më të lartë të rritjes ekonomike dhe e rreshtuar plotësisht me vlerat dhe politikën e jashtme dhe të sigurisë të Bashkimit Evropian.

"Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është zgjedhje strategjike që shoqëria jonë e ka bërë dhe qeveria e ka prioritet. Sot, me qëllim të dinamizimit të procesit dhe për të siguruar koordinim ndërinstytucional në këtë çështje prioritare, kemi themeluar Komitetin Ekzekutiv për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Kryenegociatorin me Bashkimin Evropian e autorizuar që të krijojë Task Forcë specifike, duke filluar sot me Task Forcën për Statusin e Vendit Kandidat. BE-ja duhet të

zgjerohet duke u reformuar njëkohësisht. Të marrë vendime në politikën e jashtme duke ruajtur unitetin brendshëm. Këto janë të mundura dhe Kosova është gati të kontribuojë", ka shkruar Kurti, duke shtuar se Procesi i zgjerimit sjell reforma, avancim të demokracisë e mirëqenien ekonomike. "Anëtarësimi bëhet për reforma, për demokraci, për zhvillim dhe për të kontribuar në projektin më të madh të përbashkët të paqes dhe prosperitetit", ka shkruar Kurti.

## Gola dhe Rexhepi marrin pjesë në punimet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës

PRISHTINË, 20 PRILL - Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës po merr pjesë në sesionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës i cili po mbahet nga 20 prill deri më 24 prill në Strasburg. Delegacioni përfaqësohet nga Ardian Gola, kryesues i delegacionit, njëherësh

nënkryetar i Kuvendit, si dhe nga Emilija Rexhepi, anëtare e delegacionit, njëherësh nënkryetare e Kuvendit. Gjatë qëndrimit në Strasburg ata do të marrin pjesë në punimet e sesioneve, mbledhjet e komiteve dhe aktivitetet e tjera në kuadër të APKE-së. Në kuadër të kësaj pjese të

sesionit do të trajtohen tema të lidhura me zhvillimet aktuale si dhe do të ketë adresime nga përfaqësues të lartë të shteteve dhe institucioneve të tjera. Në këtë debat, krahas folësve të tjerë, pritet që edhe nënkryetari Gola t'u drejtohet anëtarëve të asamblesë, duke paraqitur vlerësimet për procesin e fundit zgjedhor në Kosovë.





## KURTI ME OFERTË PËR LDK-në, ABDIXHIKU E REFUZON, VENDI DREJT ZGJEDHJEVE

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti, dhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, kanë dështuar të arrijnë marrëveshje të hënën për zgjedhjen e presidentit të ri. Kurti i bëri një ofertë Abdixhikut për bashkëqeverisje, duke i ofruar postin e zëvendëskryeministrit dhe katër ministri, me kusht që posti i presidentit t'i takojë LV-së, por lideri i LDK-së e refuzoi këtë ofertë, duke theksuar se nuk do të takohet më me Kurtin

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 20 PRILL** - Partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe partia opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kanë dështuar të arrijnë marrëveshje për ta zgjedhur presidentin e ri të Kosovës gjatë një takimi të hënën. Palët paralajmëruan se ky ishte takimi i fundit mes tyre.

Duke folur për media pas takimit, lideri i LV-së, kryeministri Albin Kurti, tha se kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, nuk i pranoi ofertat e tij për një marrëveshje dhe tregoi se ai tashmë i ka shkruar liderit të partisë kryesore opozitare, Bedri Hamzës së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), për një takim të mundshëm. "Më duhet të them se bisedimet ishin të

pasuksesshme sepse asnjëra nga ofertat tona nuk u pranua nga kreu i LDK-së", ka thënë Kurti duke paralajmëruar se vendi rrezikon të shkojë përsëri në zgjedhje të parakohshme nëse presidenti i ri nuk zgjedhet deri më 28 prill. Ai ka bërë me dije se ia ofroi LDK-së, në bashkëqeverisje me partnerët e tjerë, ta ketë zëvendëskryeministrin, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe tri ministri të tjera.

Në një ofertë tjetër Kurti tha se ia ofroi LDK-së postin e kryetarit të Kuvendit të Kosovës. "Unë kam preferuar që zëvendësi imi të bëhet pikërisht Abdixhiku, e në këtë mënyrë të fillojmë kapitull të ri bashkëpunimi mes LDK-së dhe LV-së", ka theksuar Kurti. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka theksuar se

përkundër përpjekjeve për 53 ditë kushtetuese për të gjetur zgjidhje rreth çështjes së presidentit, dhe vetëm presidentit, "keqardhje them se nuk kemi arritur të gjejmë një zgjidhje". "Siç kemi thënë nga fillimi, presidenti nuk mund të jetë zgjatim i qeverisë. Insistimi për një president të LV-së na dërgoi në krizë para aktgjyqimit të Gjykatës Kushtetuese. Insistimi i sërishëm për president të LV-së nuk e ndërpreu krizën që na dërgoi në Gjykatën Kushtetuese. Asgjë nuk ka ndryshuar", ka thënë Abdixhiku.

Ai ka shtuar se përkundër përpjekjes së LDK-së për konsensus, përkundër gatishmërisë për një kandidat konsensual, insistimi për një president nga radhët e VV-së e pamundëson mbështetjen e

kësaj partie për çështje parimore, logjike dhe në interes të Republikës.

Abdixhiku ka theksuar se nuk do të takohet më me Kurtin pas dështimit të bisedimeve. "Çështjet e tjera, propozimet e tjera, nuk kanë mund të trajtohen pa kapërcyer çështjen thelbësore të krizës - presidentin. Prandaj, nga sot, LDK i konsideron të përmbyllura diskutimet mbi çështjen e presidentit. Provuam për 53 nga 60 ditët kushtetuese. E drejtë është të mos shpenzojmë gjithë kohën e mbetur. Ua lëmë rastin të tjerëve të kontribuojnë në këtë drejtim. Shmangja e zgjedhjeve të reja do t'i kontribuonte stabilitetit të vendit. LDK as nuk mund t'i shkaktojë e, fatkeqësisht, as t'i parandalojë ato. Nga tash e tutje do ta vazhdojmë angazhimin për përbashkimin e madh të së djathtës brenda LDK-së si domosdoshmëri politike dhe si përgjigje ndaj nevojës së qytetarëve për një alternativë serioze, të qëndrueshme dhe shtetformuese", ka deklaruar Abdixhiku.

Ndërkohë Kurti ka thënë se i ka

shkruar kryetarit të PDK-së për një takim të mundshëm. "Unë i dërgova mesazh kryetarit të PDK-së, Bedri Hamzës, dhe të shohim se si është e mundur të ecim përpara", ka thënë Kurti. I pyetur nëse do t'i bënte ndonjë ofertë të ngjashme edhe PDK-së, Kurti nuk dëshoi të tregojë, por shtoi se "oferta për bashkëqeverisje që u ofrua për LDK-në ka qenë ekskluzive për LDK-në".

Zyrtarë të PDK-së kanë thënë rishtazi se po presin shkresë zyrtare nga kryeministri për takim.

Kurti e ka kritikuar PDK-në se në bisedimet e mëparshme kishte kërkuar që dikush nga partia opozitare të zgjidhej president pa treguar emrin e kandidatit të mundshëm. Ai e përsëriti këtë edhe të hënën, duke thënë: "PDK-ja ka kërkuar nga unë të bëj marrëveshje politike blanko, ku ata i propozojnë dy kandidatët e ne ua votojmë".

Presidenti i Kosovës zgjidhet me dy të tretat e votave në dy raundet e para apo me 61 vota në raundin e tretë, por nevojiten 80 deputetë në sallë që seanca të mund të mbahet. Prandaj, nevojitet një

# KËTA NUK JANË NORMALË

**Nuk mund të jenë politikisht normalë liderët që në vend të zgjidhjes, prodhojnë kriza të vazhdueshme. Problem nuk është vetëm mungesa e një presidenti të ri, por mungesa e përgjegjësisë, mungesa e guximit për të marrë vendime, mungesa e ndjeshmërisë ndaj situatës në të cilën ndodhet vendi**



Imer MUSHKOLAJ

Në një vend normal procesi i zgjedhjes së presidentit do të ishte një moment serioz reflektimi politik, një test i pjekurisë institucionale dhe një tregues i qartësisë strategjike të elitës politike. Por, në Kosovë ky proces është shndërruar në një tjetër episod të zakonshëm të papërgjegjësisë kolektive, ku mungesa e vullnetit për të vepruar është bërë normë, ndërsa krizat prodhohen me një lehtësi të frikshme.

Nuk është hera e parë që vendi përballet me bllokadë në zgjedhjen e presidentit. Por ajo që e bën situatën aktuale më shqetësuese është fakti se kjo po ndodh në një kontekst të përgjithshëm të pasigurisë, si në planin e brendshëm, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në një kohë kur zhvillimet gjeopolitike janë të paparashikueshme, kur raportet ndërkombëtare janë të lëkundura dhe kur Kosova ka nevojë për një zë të qartë institucional, klasa politike sillt sikur këto rrethana të mos ekzistojnë fare.

Përgjegjësia kryesore, pa asnjë dilemë, bie mbi Lëvizjen Vetëvendosje. Si forca më e madhe politike, me pushtetin ekzekutiv në duar dhe me një

mandat të fortë qytetar, ajo e ka detyrim jo vetëm kushtetues, por edhe moral, të udhëheqë proceset kyçe të shtetit. Por në vend të kësaj, ajo zgjedh të heshtë, të vonojë, të kalkulojë, duke e lënë vendin pezull në një situatë absurde.

Pse nuk propozon Vetëvendosje zyrtarisht disa emra kandidatësh koncensualë për president? A është mungesë e emrave? Vështirë të besohet. A është mungesë guximi politik? Apo kemi të bëjmë me një strategji të qëllimshme për ta mbajtur situatën të paqartë, në mënyrë që të shmangen kompromiset? Cilado që të jetë arsyeja, rezultati është i njëjtë: bllokadë, pasiguri dhe humbje e besimit qytetar.

Megjithatë, nuk mund të shpëtojnë nga përgjegjësia as partitë opozitare. Në vend që të shfrytëzojnë këtë moment për të treguar seriozitet dhe për të ofruar alternativa konkrete, ato kanë zgjedhur të rrinë në pritje, duke kalkuluar përfitimet e mundshme politike nga dështimi i qeverisë. Asnjë emër serioz nuk është hedhur në tavolinë, asnjë iniciativë nuk është marrë për të nxitur një debat të vërtetë për figurën e

presidentit të ardhshëm.

Kjo sjellje është më shumë se mungesë përgjegjësie, është një formë cinizmi politik. Sepse ndërkohë që partitë presin njëra-tjetrën, shteti mbetet peng i një procesi të bllokuar. Dhe qytetarët, si gjithmonë, janë ata që paguajnë çmimin e kësaj papjekurie.

\*\*\*

Ajo çfarë e bën edhe më të pakuptueshme këtë situatë është komoditeti me të cilin klasa politike e përjeton këtë krizë. Nuk ka ndonjë ndjenjë urgjence, nuk ka ndonjë reflektim publik për pasojat e mundshme, nuk ka ndonjë përpjekje serioze për të gjetur zgjidhje. Është sikur të gjithë të jenë pajtuar me idenë se krizat janë pjesë normale e funksionimit të shtetit.

Por, krizat nuk janë normale. Ato janë simptomë e dështimit. Dhe kur ato prodhohen në mënyrë të njëpasnjëshme, atëherë kemi të bëjmë me një model të qëllimshëm të mosqeverisjes. Andaj, pyetja më e rëndësishme është: pse politikanët po sillen sikur jetojnë në një tjetër planet? Si

është e mundur që në një kohë të tillë, kur Kosova ka nevojë për stabilitet dhe qartësi, liderët politikë të tregojnë një shkallë kaq të lartë indiference?

Një pjesë e përgjigjes qëndron në mungesën e ndjeshmërisë ndaj realitetit. Politika në Kosovë është bërë një lojë e mbyllur brenda vetes, ku interesat partiake dhe kalkulimet afatshkurtra dominojnë mbi interesin publik. Në këtë lojë, qytetarët janë thjesht spektatorë, ndërsa institucionet shndërrohen në mjete për ruajtjen e pushtetit.

Por, kjo qasje është e rrezikshme, sepse krijon një hendek gjithnjë e më të madh mes politikës dhe realitetit. Dhe, kur ky hendek bëhet shumë i thellë, pasojat janë të paparashikueshme. Zgjedhja e presidentit nuk është një çështje teknike. Është një moment që përcakton drejtimin e shtetit, që reflekton vlerat mbi të cilat ndërtohet sistemi politik. Kur ky moment trajtohet me kaq pak seriozitet, atëherë kemi një problem të thellë me vetë konceptin e shtetit.

Në vend që të kemi një debat të hapur për kriteret që duhet të plotësojë presidenti i ardhshëm, për rolin që ai ose ajo duhet të

luajë në një kontekst të ndërlikuar ndërkombëtar, përballemi me heshtje. Një heshtje që flet më shumë se çdo deklaratë.

Kjo heshtje është tregues i një mungese të thellë vizioni, sepse një klasë politike që nuk është në gjendje të artikulojë një ide të qartë për presidentin e vendit, vështirë se mund të ketë një vizion të qartë për të ardhmen e shtetit.

Ndërkohë, krizat vazhdojnë të prodhohen. Njëra pas tjetrës, pa ndonjë reflektim serioz për shkaqet dhe pasojat e tyre. Është sikur sistemi politik të jetë futur në një cikël të mbyllur, ku dështimet përsëriten pa u mësuar asgjë nga to.

Në fund të fundit, problemi nuk është vetëm mungesa e një presidenti të ri. Problemi është mungesa e përgjegjësisë, mungesa e guximit për të marrë vendime, mungesa e ndjeshmërisë ndaj situatës në të cilën ndodhet vendi.

Derisa këto mungesa të vazhdojnë, çdo krizë e re do të jetë vetëm një kapitull tjetër në një histori të gjatë të dështimeve politike. Një histori që, për fat të keq, po shkruhet çdo ditë para syve tanë.

marrëveshje mes partive parlamentare për këtë çështje, duke qenë se asnjëra parti - madje as ajo në pushtet e Kurtit, Lëvizja Vetëvendosje me 57 deputetë - nuk e ka një numër kaq të madh deputetësh në Kuvendin me 120 vende.

Pasi Vjosa Osmanit i mbaroi mandati në fillim të muajit dhe vendi nuk arriti ta emërojë zëvendësuesin e saj, kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, u emërua ushtruese e detyrës së presidentit më 4 prill. Edhe vetë Haxhiu u bëri thirrje të dielën partive për arritjen e një konsensusi për zgjedhjen e presidentit, duke theksuar se vendi nuk duhet të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme.

## Krasniqi thotë se Abdixhiku ra në 'kurthin politik' të Kurtit



Albert Krasniqi nga "Demokracia Plus" ka vlerësuar se kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka rënë në "kurthin politik" të Albin Kurtit të Vetëvendosjes kohën e fundit. "Qëllimi i Kurtit nuk ka qenë gjetja e një zgjidhjeje për çështjen e presidentit. Ai tashmë e kontrollon këtë post dhe synimi i tij është ta mbajë sa më gjatë përmes prodhimit të krizave politike dhe zvarritjes së proceseve. Që

nga shpallja e aktgjykimit të Kushtetueses, strategjia ka qenë të amortizohet efekti politik që një afrim i Osmanit me LDK-në mund të sillte. Rrjedhja e votave synohej të ndalej përmes 'negociatave' të fokusuara vetëm me LDK-në. Duke rënë në këtë kurth politik, LDK jo vetëm që i mundësoi Kurtit të blejë kohë, por edhe ta zbehte efektin politik që Osmani mund të prodhonte", ka thënë Krasniqi.

# 16 - TË MILIONËT E ALBINIT!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**Deklarimi i paturpësisë:** Pasi u bënë publike deklarimet e pasurisë së politikanëve dhe shpurës së tyre, e shohim se Kosova nuk qenka vend edhe aq i varfër, sidomos për ata që, sipas ligjit, detyrohen ta paraqesin pasurinë në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Realisht, pasqyrat financiare janë ndoshta vetëm 20 për qind krahasuar me vlerën e vërtetë që e kanë paraqitur “lulvegjëlit” e Kosovës. Qeveria Kurthi 3 është qeveri puro kleptokratike (e hajnave), prandaj nuk befason aspak pasurimi i tyre përrallor brenda këtij mandati qeverisës prej cubave dhe zhvatësve të buxhetit. Po si qenka e mundur që brenda një mjedisi shumë të korruptuar, KM i Kosovës Albin Kurthi të deklarojë se i ka vetëm 16 euro në llogarinë bankare kur thuaja i ka të gjitha “dhuratë” nga shteti aq më parë që në LV dhe institucionet që udhëhiqen nga ky subjekt paramilitar, pa dijen dhe lejen e Kurthit nuk mund të shkrepet as edhe një pordhë e vetme e lëre më të shkohet në kanaxheqe apo syneti! Kurthi kontrollon çdo gjë, prej hajnisë 1 euro e deri te peshkaqenët si Martin Struja, paramilitari Hekuran Murati, Hajnrollah Çeko, Ben Vito Korleone, Hajnesha e Radoiçiqit, Tore Subvencia, Ton

Speci dhe 4000 hajdutët e Al(b)in Babës. Pastaj Faraoni i Pejës dhe Dhunuesi i Policisë së Kosovës. Nuk mund të gjeni KM në rajon dhe më gjerë që në mënyrë aq pasionante dhe patologjike i mbron varësit e dyshuar për korrupsion se sa që e bënë Albin Baba. I ka lejuar të vjedhin sa dhe kur kanë dashur për të qeverisur më lehtë përmes shantazhimit me “Burgun e Dubravës në 12 kate...”. Në një vend ku qindra milionë euro kanë humbur “nëpër telat e rrymës” dhe qindra miliona euro në tenderë njëburimorë, falë qeverisë së hajnave të paskrupullit, 16 euro në llogarinë bankare të KM Kurthi mund të përkthehet si 16 për qind moral dhe 84 për qind hajni. Në deklarinim e pasurisë, përjashtuar shumë pak rasteve, maskën e mashtruesve e kanë të njëjtë, pozitë dhe opozitë! Kush brengoset për “varfërinë” e Kurthit, e bartë këtë brengë koti. Kurthi nuk është rast social, është i pasur dhe kjo vërtetohet vetëm kur të “rrëzohet nga fiku”. Sikur të gjithë diktatorët!

**Plesidenti, plesidenti:** Albin Kurthi e “ekzekutoi” politikisht Vojsa Osmanin sepse ia mori “bajrakun” në politikën e jashtme. Sepse deshi të bëhej: “më katolik se Papa”. Kjo te

Kurthi nuk lejohet. Nuk mund të lidhen “dy atllarë në një mullar ..”. Si kundër çdo Bruti apo Kasi që duan ta vrasin politikisht Cezarin (Albinin), në sulm u hodh garda pretoriane e LV-së që, përkthyer në shqip nënkupton zagarët virtualë të Kurthit për ta pushkatuar politikisht, “kombtarisht” dhe moralisht kundërshtarin, në rastin konkret Vojsa Osmanin e që nuk ka qenë aspak e vështirë. Me intelektualë si Gima i Gushavcit, Dona Çadra, Lenka Quko, Resha Ziu, Ana Toshi, Mef Bajçina, Mal Bisha, Krakovina, Prof. Dr. Ramçe, Tomçe Kadileri, Pozhar Llaskuci me trima dhe trimëshra shumë, Vjosa ishte e mbaruar. Nuk mbeti kush ta mbrojë e as ta vajtojë! As Trampi e as Don Trapi. Kurthi e do për president Glauk Pinokion. Këtë Miren e ka si kandidate të dytë shkaku i votave të Listës Serbe. Megjithatë, Kurthi këtë post e ka të rezervuar për Lenka Haxhiun me emrin artistik Lenka Quko. Nëse do të ketë mundësi askënd tjetër nuk do ta bënte presidente. As Lumir Abdixhikun. Kurthi i duhet një “personalitet” pa shtyllë kurrizore, i shtrirë përherë para këmbëve të tij. Kurthi kurrë nuk do të bënte koalicion me PDK-në sepse nuk mund ta shkërmoq apo ta fusë në

procesin e tretjes prandaj nuk takohet me ta. Me LDK-në po. Madje edhe mund të bëjë koalicion por nuk besoj se ua jep postin e presidentit. Mund t’ua jep kryetarin e Kuvendit dhe disa ministri. Presidenti që nuk i nënshtrohet Kurthit më shumë se 100 për qind paraqet rrezik për qeverinë Kurthi 3. Pse? Sepse ka disa kompetenca që i ndanë me KM. Sepse, në çdo situatë, me dorëheqje mund të provokon zgjedhje të reja. Edhe kur nuk i konvenon Kurthit. Ka shumë mundësi për një koalicion LV - LDK në nivel qendror dhe lokal. Sidomos në Prishtinë ku “i biri i Kadrushit” e nxjerr nga loja Uranin dhe e futë në lojë “bishtin” e LV-së. Sfeqlën e Prishtinës. Po ta shohim. Albin Kurthit nuk i konvenojnë zgjedhjet, kurrsesi. Këto zgjedhje më së shumti i konvenojnë LDK-së dhe Vojsa Osmanit. LDK-ja do të rritej kurse Vojsa do të shpëtonte që të hidhet në “shportën e mbetjeve politike” duke u marginalizuar për katër vitet e ardhshme. Si “bashkëthemelues” e Bordit të “Paqes” me Donald Trap, i mbetet edhe një mundësi të bëhet anëtare e Ekipit Pregatitor për Gazën me mision special... gatimi i krelanave dhe flive për 20 ushtarët e FSK-së që

do të dërgohen në Gazë.

**Jugonostalgjikët dhe çetnikët shqipfolës:** Asnjë qeveri nuk ka pasur më shumë jugonostalgjikë, zagarë të Serbisë, kriminelë të UDB-së dhe çetnikë që flasin shqip se qeveria e Albin Kurthit. Kanë metastazuar në të gjitha institucionet si bartës të posteve më të larta, në media dhe si këshilltarë. As Serbia nuk e sulmon UÇK-në dhe luftëtarët e lirisë më shumë se “pjella e keqe e LV-së”. Vudi Gjymshiti, nipi i Arkanit dhe hajni i parave të Bacit Adem Demaçi e kanë të hapur 24 orë “grazhdin e Albinin”. Ta rishkruajnë historinë ku mungojnë shkaku i përcaktimit antikombëtar, si nostalgjikët të Jugosllavisë dhe zagarë të Serbisë. Në me krye kryezagarin e rëndë 40 milionë euro që asgjë nuk ka bërë për Kosovën dhe shqiptarët përveç se duke punuar kundër e ka rrumbullakuar 40 milionëshin e eurove! Tash përmes zagarucave shoqëruar do të bëhet Baba i historisë së re dhe mohues e vlerave të vërteta njerëzore, kombëtare, politike dhe morale si dishepull i autonomisë dhe dhunues i pavarësisë! A paskemi bërë aq shumë mëkate që ta kemi këtë gjendje? Pyeteni Albin Kurthin.

## AAK-ja kërkon që pensionet e veteranëve të UÇK-së të jenë sa paga minimale

**PRISHTINË, 20 PRILL** - Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) ka shprehur mbështetje të plotë për kërkesat e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, duke i cilësuar ato legjitime dhe të domosdoshme për trajtim institucional. Në një deklaratë

zyrtare, AAK ka theksuar se kërkesat e paraqitura nga veteranët në komunikimin e 20 shkurtit duhet të adresohen pa vonesa dhe me prioritet nga institucionet e vendit. “Lufta çlirimtare dhe sakrificat e atyre që kontribuuan për lirinë dhe pavarësinë përbëjnë një themel të

panegociueshëm të shtetësisë dhe rendit demokratik. Çdo përpjekje institucionale duhet të jetë në përputhje me këtë realitet historik dhe moral”, thuhet në deklaratë. Grupi parlamentar i AAK-së ka renditur tri kërkesa kryesore që mbështet: Miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Vlerave

të Luftës së UÇK-së; Vendosi e pensioneve të veteranëve në nivelin e pagës minimale; Zbatimin e plotë dhe pa vonesa të ligjit ekzistues. AAK-ja ka bërë me dije se do të angazhohet për trajtimin prioritar të këtyre çështjeve në Kuvend, duke i ftuar njëkohësisht të gjitha forcat



politike për mbështetje të përbashkët.

## Dështon për të tretë herë radhazi mbledhja e KGJK-së, tash mungon kandidati për kryesues

PRISHTINË, 20 PRILL - Në mungesë të anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Besnik Bislimaj, ka dështuar të mbahet mbledhja e 365-të, në të cilën në rend dite ishte zgjedhja e kryesuesit si dhe shpallja e konkursit për kryetar të Gjykatës Administrative e konfirmimi për bashkëpunëtorë profesionalë në Gjykatën Supreme.

Edhe takimet 2 dhe 14 prill 2026 kishin dështuar të

mbaheshin pasi kishin munguar Ahmet Imami më 2 dhe 14 prill Fahret Vellija, raporton "Betimi për Drejtësi".

Kuorumi për mbajtjen e takimeve të KGJK-së është së paku nëntë anëtarë, ndërsa me mungesën e Bislimajt numri i tyre ka rënë në tetë, duke bërë kështu të pamundur mbajtjen e këtij takimi.

KGJK-ja, sipas Kushtetutës, është e paraparë të ketë 13

anëtarë, aktualisht ka nëntë, ndërkaq për tre të tjerë po zhvillohet procesi i përzgjedhjes në Kuvendin e Kosovës, kurse për një anëtar nga radhët e gjyqësorit, respektivisht nga Gjykata Supreme, procesi i përzgjedhjes ka marrë rrugët gjyqësore. Kujtojmë se kandidatë për kryesues të KGJK-së janë Rrustem Thaqi, gjyqtar nga Gjykata Supreme e Kosovës dhe Besnik Bislimaj.



## KOSOVA E SHPALL ORGANIZATË TERRORISTE GARDËN REVOLUCIONARE ISLAMIKE TË IRANIT

PRISHTINË, 20 PRILL - Qeveria e Kosovës e ka shpallur organizatë terroriste Korpusin e Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC) gjatë një mbledhjeje të hënën në Prishtinë.

Kryeministri Albin Kurti tha se "përmes këtij vendimi Kosova e forcon qëndrimin e saj në mbrojtjen e sigurisë ndërkombëtare, vlerave demokratike dhe të drejtave të njeriut". "Ky është rreshtim i qartë i Kosovës përkrah aleatëve të vet strategjikë në luftën e përbashkët kundër terrorizmit", theksoi Kurti.

Ai e përshkroi IRGC-në si "strukturë që e përdor terrorizmin dhe dhunën e organizuar si instrument i politikës së jashtme, duke kontribuar në destabilizimin rajonal dhe global".

Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike të

Iranit është krahu ideologjik i ushtrisë së Teheranit dhe u krijua pas revolucionit të vitit 1979 për ta mbrojtur udhëheqjen klerikale.

Garda kontrollon ose zotëron kompani në gjithë ekonominë iraniane, përfshirë sektorë strategjikë kryesorë.

Disa vende tashmë e kanë shpallur organizatë terroriste IRGC-në, përfshirë Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Rishtazi, Bashkimi Evropian e shpalli atë si terroriste pasi Teherani i shtypi në mënyrë brutale protestat antiqeveritare në fillim të këtij viti.

Organizatat për të drejtat e njeriut kanë thënë se mbi 6 000 njerëz u vranë gjatë protestave në Iran. Sipas tyre, protestuesit u vranë nga forcat e sigurisë, përfshirë Gardën Revolucionare, të cilat qëlluan drejtpërdrejt mbi



protestues.

Irani, me një popullsi prej mbi 91 milionë banorësh, nuk e njeh Kosovën shtet dhe nuk ka

marrëdhënie diplomatike zyrtare me vendin.

Futja e një grupi apo organizate në listën e zezë

nënkupton zakonisht ngrirje asetesh së saj në atë vend dhe regjim vizash për udhëheqësit dhe zyrtarët e saj.

## KUVENDI MBAN TRI SEANCA, E PARA TË ENJTEN DHE DY TË TJERA TË PREMTEN



PRISHTINË, 20 PRILL - Kuvendi i Kosovës do të mbajë tri seanca plenare gjatë kësaj jave, ka bërë me dije kryeparlamentarja Albulena Haxhiu pas mbledhjes së Kryesisë. Sipas saj, seanca e parë do të mbahet të enjten, më 23 prill, ndërsa dy të tjerat janë planifikuar për të premtën.

Haxhiu ka njoftuar se në seancën e së enjtes do të procedohen 10 projektligje, ndërsa në seancat e së premtes pritet të shqyrtohen marrëveshje ndërkombëtare si dhe çështja e bordit të RTK-së dhe KPM-së.

Një ndër seancat e së premtes do të jetë solemne për Eliot Engel, kongresistin i cili vdiq më 10 prill. Ajo ka theksuar se në mbledhjen e kryesisë ka pasur pajtim të plotë për rëndësinë e këtyre çështjeve dhe për nevojën që të ecet përpara me përgjegjësi institucionale, duke pasur parasysh numrin e madh të ligjeve që presin leximin e dytë.

Haxhiu ka folur edhe për shqetësimet lidhur me mosmiratimin e marrëveshjes për Bordin e Paqes, duke bërë me dije se të mërkurën pritet të mbahet një takim i grupit

punues, pas të cilit çështja do të procedohet në Kuvend. Ajo ka deklaruar se pret që Komisioni për Punë të Jashtme ta trajtojë këtë çështje sa më shpejt dhe ta dërgojë për shqyrtim në seancë plenare. "Në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit ne e dëgjuam shqetësimin në raport me mosaprovimin e marrëveshjes për Bordin e Paqes e kuptuam se të mërkurën do të ketë grup punues, pastaj do të procedohet në Kuvend. Presim që sa më parë Komisioni për Punë të Jashtme ta procedojë në Kuvend", është shprehur Haxhiu.

## Ndalohe punimet në 16 vendpunishte, 9 prej tyre në Gjakovë

PRISHTINË, 20 PRILL - Inspektorati Qendror i Punës ka njoftuar se në vazhdimësi të aksionit

inspektues në sektorët me rrezikshmëri të lartë, në të gjithë Kosovën, ka ndërmarre veprime të tjera në 48 orët e

fundit. Sipas raportit të fundit, në ditën e katërt të inspektimeve janë ndaluar punimet në 16 biznese, teksa

janë dhënë vërejtje në 11 të tjera. Rastet e ndalimeve janë në Gjakovë, Podujevë dhe Drenas



## QEVERIA KURTI MIRATON 23 VENDIME VETËM NË NJË MBLEDHJE

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 20 PRILL** - Qeveria e Kosovës ka zhvilluar të hënën mbledhje të rregullt, në të cilën ka miratuar disa vendime në interes të vendit dhe disa projektligje të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Kabineti qeveritar ka miratuar Projektligjin për Ratifikimin e Amendamentit nr. 2 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2020; Projektligjin për Ratifikimin e Amendamentit nr. 1 të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2019, Pjesa e Dytë, Objektivi 1; Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes për Tregti të Lirë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të EFTA-s. Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e Marrëveshjes për Tregti të Lirë ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Shteteve të EFTA-s (Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra). Kjo marrëveshje krijon një zonë të tregtisë së lirë në përputhje me nenin XXIV të GATT 1994 dhe nenin V të GATS, duke liberalizuar tregtinë e mallrave dhe shërbimeve dhe duke përmirësuar qasjen në treg për investime.

Po ashtu, qeveria ka miratuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive Ekzekutive. "Një ndër prioritetet e Qeverisë së Kosovës është që shteti i Kosovës të ketë një rregullim të mirë në fushën e reformës së administratës publike e ky rregullim do të arrihet përmes këtij Projektligji. Në mesin e vendeve të rajonit të cilat vlerësohen për progresin në Reformën e Administratës Publike (RAP) përmes raportit vjetor nga Komisioni Evropian, Kosova është vendi me numrin

më të madh të agjencive, dhe agjencive që raportojnë në Kuvend", është bërë me dije në njoftimin e qeverisë.

Po ashtu, është miratuar Projektligji për Ratifikimin e Protokollit Shtesë 6 për Tregtinë në Shërbime për Marrëveshjen mbi Ndryshimin dhe Pranimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore, i cili synon liberalizimin progresiv të tregtisë në shërbime ndërmjet palëve kontraktuese.

Ky protokoll është negociuar në kuadër të Marrëveshjes së CEFTA-s dhe përcakton rregulla për qasjen në treg, trajtimin kombëtar, transparencën dhe eliminimin e barrierave rregullatorë për sektorë të ndryshëm të shërbimeve në përputhje me parimet e Organizatës Botërore të Tregtisë (GATS).

Kabineti qeveritar ka miratuar edhe Projektligjin për Ratifikimin e Protokollit Shtesë 5 të Marrëveshjes për Aderimin dhe Amendamentimin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore.

Ky protokoll synon thjeshtësimin e inspektimeve, reduktimin e formaliteteve të import-eksportit, shkëmbimin elektronik të të dhënave, njohjen reciproke të testeve laboratorike dhe programit të Operatorëve Ekonomikë të Autorizuar, zbatimin efektiv të kontrollit të riskut.

Gjithashtu, ky protokoll i shtrin efektet e tij edhe tek të gjitha agjencitë e tjera që veprojnë në kufi dhe kjo është vlera e shtuar thelbësore e këtij protokollit, e cila është mbështetur në filozofinë e lehtësimit të tregtisë së miratuar nga të gjitha vendet anëtare të OBT në marrëveshjen e Lehtësimit të Tregtisë.

"Qeveria ka miratuar Projektligjin për Ratifikimin e Protokollit Shtesë 7 për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve, i Marrëveshjes për Amendamentimin dhe Aderimin në Marrëveshjen e Tregtisë së



Lirë të Evropës Qendrore. Ky Protokoll synon t'ia mundësojë Palëve të CEFTA-s krijimin e një qasje më të strukturuar ndaj konsultimeve, ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve brenda CEFTA-s. Po ashtu, ka miratuar Projektligjin për Inovacion dhe Ndërmarrësi. Qëllimi i këtij projektligji është të përcaktojë parimet, rregullat, organizimin dhe mekanizmat institucionalë për mbështetjen, promovimin dhe nxitjen e aktiviteteve inovative dhe ndërmarrëse, me qëllim të përsheptimit të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe mjedisor në Republikën e Kosovës. Miratimin e kabinetit qeveritar e ka marrë edhe Projektligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore. Me këtë Projektligj parashihet themelimi, organizimi dhe funksionimi i Inspektoratit Qendror të Trashëgimisë Kulturore si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit. Me themelimin e këtij mekanizmi të rëndësishëm do të krijohen kushtet ligjore, profesionale dhe funksionale për të bërë kontrollin dhe vlerësimin e kushteve dhe të gjendjes së ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe sipas

nevojës ndërmerr masat e duhura për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në vend", është theksuar në njoftimin për medie.

Gjithashtu, ka miratuar Projektligjin për Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave. Agjencia është organ përgjegjës për menaxhim të emergjencave në nivel vendi, të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Po ashtu, ka miratuar Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve. "Çështja kryesore e trajtuar në këtë projekt-rregullore është përmirësimi dhe plotësimi i kornizës ekzistuese për integrimin e të huajve në Republikën e Kosovës, përmes ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores (QRK) nr. 09/2019. Ndryshimet fokusohen në, forcimin e mekanizmave institucionalë për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Zgjatja e afatit për strehim elementar për personat me status refugjati, personi me status të mbrojtjes plotësuese apo personi me mbrojtje të përkohshme. Është miratuar edhe vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të

Qeverisë për emërimin e Bordit të Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike Qendrore 'Telekomi i Kosovës' Sh. A., përmes të cilit kryesues zgjidhet, Shaban Neziri", thuhet në njoftim.

Qeveria ka ndarë mjete financiare në vlerë prej 20.721.00 (njëzet mijë e shtatëqind e njëzet e një) eurosh për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2026, në Qendrën Rajonale të Nismës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë, me seli në Shkup.

Gjithashtu, ka miratuar nismën për lidhjen e Marrëveshjes së Grantit ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, KOSTT-it dhe KfE-së, për Zhvillimin e Sektorit të Energjisë (Faza VII) - Përmirësimi i Rrjetit të Transmetimit.

Qeveria ka miratuar Koncept dokumentin për Fushën e Kontrollit të Tregtisë me Mallra Strategjike, qëllimi kryesor i të cilit është përmirësimi i kontrollit në fushën e tregtisë me mallra strategjike si parakusht për funksionimin e lirë të tregut, mbrojtjen e operatorëve ekonomikë dhe mundësimin e konkurrencës së drejtë, kontrollin dhe mbikëqyrjen e avancimit të sigurisë shtetërore, interesat e politikës së jashtme të Republikës së Kosovës drejt përmbushjes së detyrimeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare. Qeveria e drejtuar nga Albin Kurti ka miratuar vendimin për themelimin e trupave institucionale për anëtarësim në Bashkimin Evropian. "Qeveria ka miratuar vendimin për shpalljen e Organizatës së Trupave të Gardës Revolucionare Islamike (IRGC), si organizatë terroriste në territorin e Republikës së Kosovës. Miratuar vendimin për propozimin e Ministrisë së Drejtësisë për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës", ka njoftuar qeveria.

## MINISTRJA KUSARI-LILA PARAQET PAKETË MASASH PËR ZHVILLIM EKONOMIK, TREGTI DHE INOVACION

**PRISHTINË, 20 PRILL** - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës të hënën paraqiti një sërë iniciativash që synojnë forcimin e zhvillimit ekonomik, rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe avancimin e inovacionit dhe ndërmarrësisë në vend.

Në fokus të prezantimit ishin marrëveshjet tregtare, reformat ligjore dhe mekanizmat mbështetës për bizneset, të cilat pritet të ndikojnë në rritjen e eksporteve, krijimin e vendeve të reja të punës dhe përmirësimin e klimës së investimeve në Kosovë.



Sipas ministres, Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me shtetet e EFTA, përfshirë Zvicër, Norvegji, Islandë dhe

Lihtenshtajni, parasheh eliminimin e tarifave për shumicën e produkteve industriale, përmirësimin e

qasjes në tregjet bujqësore dhe përfshirjen e shërbimeve si ato financiare, IT, transport dhe turizëm.

Po ashtu, protokollat 5, 6 dhe 7 të CEFTA synojnë lehtësimin e procedurave tregtare, liberalizimin e tregtisë së shërbimeve dhe krijimin e mekanizmave më efikas për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në përputhje me standardet e OBT-së dhe Bashkimit Evropian.

Në kuadër të reformave ligjore u paraqit edhe Projektligji për Inovacion dhe Ndërmarrësi, i cili parasheh krijimin e Fondit për Inovacion përmes granteve, subvencioneve dhe mbështetjes për startup-et,

teknologjinë, patentimin dhe zhvillimin e bizneseve.

Gjithashtu, parashihet zhvillimi i infrastrukturës inovative, përfshirë parqet teknologjike, inkubatorët dhe klasterët, si dhe krijimi i Këshillit Kombëtar për Inovacion.

Ministria bëri me dije se do të forcohet edhe kontrolli i tregtisë së mallrave strategjike, duke harmonizuar legjislacionin me rregullat e Bashkimit Evropian për mallra me përdorim të dyfishtë. Ajo theksoi se synimi i këtyre iniciativave është rritja ekonomike, shtimi i eksporteve, krijimi i vendeve të reja të punës dhe rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve të Kosovës.

# ELON MUSK DHE JEFF BEZOS, KOKË MË KOKË NË GARËN PËR HAPËSIRËN

Gara për të rikthyer astronautët amerikanë në Hënë po hyn në një fazë vendimtare, me SpaceX të Elon Musk dhe Blue Origin të Jeff Bezos që konkurrojnë për kontratat e NASA-s, të cilat mund të përcaktojnë epokën e ardhshme të eksplorimit hënor.

Në lojë nuk është vetëm prestigji. Fituesi, ose fituesit, e raundit të ardhshëm të kontratave për Sistemin e Uljes së Njeriut (HLS) të NASA-s do të ndihmojnë në përcaktimin e mënyrës se si Shtetet e Bashkuara do të ndërtojnë një prani të qëndrueshme në Hënë dhe do të përgatiten për misione të ardhshme drejt Marsit.

Ndërsa të dy kompanitë ndajnë të njëjtin qëllim, vendosjen e njerëzve përsëri në sipërfaqen hënore, trajektorët teknologjike dhe afatet e tyre kohore ndryshojnë ndjeshëm.

## Elon Musk dhe avantazhi i SpaceX në teknologjinë e ripërdorshme

SpaceX hyn në këtë garë me një avantazh të konsiderueshëm operacional, të ndërtuar gjatë më shumë se një dekade lëshimesh orbitale dhe zhvillimi të raketave të ripërdorshme.

Raketat Falcon 9 dhe Falcon Heavy të kompanisë kanë përfunduar qindra misione, me fazat e para të ripërdorshme që ulen rregullisht në platforma detare dhe baza tokësore. Ky ritëm i ka mundësuar SpaceX-it të përmirësojë ripërdorshmërinë e shpejtë, të ulë kostot e lëshimeve dhe të grumbullojë një sasi të madhe të dhënash fluturimi.

Në qendër të ambicieve të saj hënore është Starship, një mjet gjigant plotësisht i ripërdorshëm, i projektuar për misione në hapësirën e thellë. Varianti Starship Human Landing System, i përzgjedhur nga NASA në vitin 2021 për programin Artemis, është ndërtuar për të transportuar astronautë nga orbita hënore në sipërfaqe dhe përsëri mbrapsht.

Me një lartësi të krahasueshme me një ndërtesë 15-katëshe, Starship HLS përfaqëson një ndryshim të madh shkalle krahasuar me mjetet e mëparshme të uljes në Hënë. Ai është projektuar për të mbajtur ngarkesa më të mëdha dhe potencialisht për të mbështetur operacione të zgjatura në sipërfaqe.

Motorët Raptor të SpaceX, që po evoluojnë drejt versioneve më të thjeshtuara v3, synojnë të përmirësojnë raportin shtytje/peshë duke ulur njëkohësisht kompleksitetin e prodhimit. Testimet e



vazhdueshme të prototipeve Starship, edhe pse të shoqëruara me dështime të dukshme në lëshime, kanë përsheptuar ciklet e zhvillimit. Për sa i përket frekuencës së fluturimeve dhe pjekurisë së teknologjisë, SpaceX operon në një afat kohor që e vendos të paktën një dekadë përpara çdo konkurrenti.

## Qasja ndryshe e Blue Origin të Jeff Bezos

Blue Origin, e themeluar nga Jeff Bezos, ka ndjekur një rrugë zhvillimi më graduale. Kompania arriti fluturimet e para të njohura suborbitale me njerëz përmes mjetit New Shepard dhe po avancoi raketën orbitale New Glenn. Për programin hënor të NASA-s, Blue Origin drejton një konsorcium që përfshin Lockheed Martin dhe kontraktorë të tjerë të industrisë hapësinore. Mjeti i saj i propozuar, Blue Moon, ndjek një filozofi dizajni që i ngjan elementeve të misioneve të epokës Apollo, me një konfigurim shumëfazësh për të transportuar astronautë nga orbita në sipërfaqe.

Ndryshe nga sistemi i vetëm dhe gjigant i SpaceX, koncepti i Blue Origin thekson modularitetin dhe qasjet klasike të inxhinierisë. Megjithatë Blue Origin është pas SpaceX për sa i përket ritmit të lëshimeve orbitale, kompania ka zgjeruar në

mënyrë të qëndrueshme prodhimin e motorëve dhe infrastrukturën e lëshimeve. Motori BE-4, që fuqizon New Glenn dhe mbështet edhe raketat e United Launch Alliance, përfaqëson një hap të rëndësishëm në zhvillimin e saj teknologjik.

## Ekulibri strategjik i NASA-s

Programi Artemis i NASA-s synon të krijojë një prani të qëndrueshme njerëzore në Hënë, duke filluar me misionin Artemis III. Agjencia ka sinjalizuar interes për të ruajtur konkurrencën mes ofruesve privatë, në vend që të mbështetet vetëm në një kontraktor.

Duke mbështetur më shumë se një sistem uljeje, NASA synon të sigurojë rezervë operative, kontroll të kostove dhe inovacion.

Përzgjedhja e SpaceX për kontratën fillestare HLS shënoi një largim nga praktikat tradicionale të kontraktimit në industrinë hapësinore. Megjithatë, më vonë NASA i dha një kontratë të dytë për ulje hënore ekipit të Blue Origin, duke përforcuar strategjinë e saj me shumë ofrues.

Kjo garë pasqyron një ndryshim më të gjerë drejt partneriteteve publike-private në eksplorimin hapësinor, ku agjencitë qeveritare mbështeten te kompanitë komerciale për kapacitetet e lëshimit dhe uljes.

## Shkalla dhe filozofia

Një nga kontrastet më të dukshme mes dy qasjeve qëndron te shkalla.

Starship është projektuar jo vetëm për misione hënore, por edhe për kolonizimin e Marsit dhe transportin masiv të ngarkesave. Madhësia dhe kapaciteti i saj tregojnë vizionin afatgjatë të Musk për zgjerimin ndërplanetar.

Koncepti i Blue Origin është relativisht më i vogël dhe më i fokusuar në misione specifike, duke u përqendruar te besueshmëria dhe zhvillimi gradual i kapaciteteve.

Këto dallime pasqyrojnë filozofitë më të gjera të themeluesve. Musk ka ndjekur vazhdimisht përsëritjen e shpejtë dhe afate agresive, duke pranuar rrezikun e dukshëm për të përsheptuar zhvillimin.

Bezos ka theksuar përmirësimin gradual të inxhinierisë dhe ndërtimin e infrastrukturës.

## Faktori kohë

Koha mund të rezultojë vendimtare.

SpaceX ka kryer disa fluturime testuese të Starship dhe vazhdon të përmirësojë mjetin për operacione orbitale dhe hënore. Edhe pse gatishmëria e plotë për ulje njerëzore kërkon ende testime dhe certifikime të mëtejshme, ekosistemi i saj i ripërdorshëm i lëshimeve tashmë është i konsoliduar.

Blue Origin ndodhet më herët në ciklin e zhvillimit të raketave të rënda. Përparimi i saj me New Glenn dhe pajisjet për ulje hënore do të përcaktojë se sa shpejt mund të arrijë të njëjtat standarde operative.

Koha e misioneve Artemis shton një kompleksitet shtesë. Vonesat në raketën Space Launch System ose në anijen Orion mund të ndikojnë afatet e uljes, pavarësisht se cili ofrues privat është gati i pari.

## Pasoja më të gjera

Përtej uljes së menjëhershme në Hënë, rezultati i kësaj gare mund të ndikojë drejtimin e liderit amerikan në hapësirë.

Një rikthim i suksesshëm në Hënë do të shënonte herën e parë që astronautët vendosin këmbën atje që nga viti 1972. Ai gjithashtu do të sinjalizonte pjekurinë e fluturimeve komerciale hapësinore si një motor kryesor i eksplorimit. Rivaliteti mes Musk dhe Bezos nuk është thjesht një përplasje personalitetesh. Ai përfaqëson dy modele të ndryshme të integritetit të industrisë private me politikën kombëtare hapësinore.

Ndërsa NASA avancoi me misionet Artemis, Hëna është bërë sërish një terren prove, jo vetëm për teknologjinë, por edhe për vizione konkurruese mbi të ardhmen e njerëzimit përtej Tokës. / bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Kombëtarja e Kosovës U19 për vajza ngjitet në Ligën A

**PRISHTINË, 20 PRILL** - Kombëtarja e Kosovës U19 për vajza ka arritur një sukses të rëndësishëm pas paraqitjeve shumë pozitive në

turneun e UEFA-s të mbajtur në Lituani. Me lojë të disiplinuar, përkushtim dhe dy fitore bindëse, vajzat dardane kanë

dëshmuar potencialin dhe cilësinë e tyre në arenën evropiane. Kombëtarja e Kosovës U19 (vajzat) është

ngjitur në Ligën A, duke shënuar hap të madh përpara për futbollin e vajzave të reja në Kosovë.



## BETEJË E ASHPËR NË SUPERLIGË PËR VENDIN E PARË DHE MBIJETESË

**PRISHTINË, 20 PRILL** - Xhiroja e 29 në Albi Mall Superligën e Kosovës ka sjellë ndeshje të forta dhe plot emocione, me rezultate që ndikojnë ndjeshëm në renditjen tabelare si në krye ashtu edhe në pjesën e poshtme të saj. Në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj, Drenica ka shënuar fitore shumë të rëndësishme për mbijetesë, duke e mposhtur kampionen në fuqi, Dritën, me rezultat 1:0. Golit vendimtar është realizuar në minutën e 40 nga sulmuesi Ronaldo, i cili ka shënuar gol të bukur që ka dalë të jetë vendimtar për tri pikët e skuadrës kuqezi. Me këtë fitore, Drenica është larguar përkohësisht nga zona e rënies duke u ngjitur në vendin e shtatë me 35 pikë, ndërsa Drita mbetet në krye të tabelës me 54 pikë. Edhe Malisheva ka regjistruar fitore të madhe në garën për pozitën që dërgojnë në garat evropiane, duke e mposhtur Ballkanin me



rezultat 4:2 në stadiumin "Liman Gegaj". Pas një pjese të parë të mbyllur me epërsi minimale për mysafirët, skuadra vendase ka reaguuar fuqishëm në pjesën e dytë. Etnik Brruti ka realizuar dy herë, një herë nga penalltia, ndërsa Assane Diatta dhe Laurent Xhylani (nga penalltia) kanë kompletuar përmbyshjen e madhe. Me këtë fitore Malisheva është ngjitur në

vendin e katërt me 43 pikë, duke iu afruar zonës evropiane, ndërsa Ballkani mbetet në vendin e dytë me 49 pikë. Drama nuk ka munguar as në Gjilan, ku Dukagjini i Klinës ka arkëtuar tri pikë të arta pas një fitoreje 3:2 ndaj Gjilanit. Ndeshja është karakterizuar me përmbyshje dhe ritëm të lartë. Altin Merlaku ka shënuar për 1:0 në minutën e 23-të. Robert Rrahmani ka barazuar

shifrat në minutën e 51-të, por pesë minuta më vonë epërsinë e klinasve e ka rikthyer Drenica Isufi. Fundi i ndeshjes ishte dramatik. Udoyen Akpan ka realizuar me goditje të bukur nga zona në minutën e 92-të për shifrat 2:2, por kur Gjilani po kërkonte përmbyshjen e plotë të rezultatit në sekondat e fundit, përmes një kundërsulmi të shpejtë Dardan Morina ka shënuar për fitoren e Dukagjinit, 3:2. Dukagjini me fitore është forcuar në pozitën e gjashtë me 38 pikë, ndërsa Gjilani i pesti i ka 43 pikë. Në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë derbi ndërmjet Llapit dhe Prishtinës është mbyllur pa gola, 0:0, në një ndeshje të karakterizuar me ritëm të lartë dhe raste të shumta nga të dyja skuadrat. Me këtë pikë të fituar, Prishtina mbetet në pozitën e tretë me 44 pikë, ndërsa Llapi renditet i nënti me 33 pikë. E në ndeshjen tjetër të zhvilluar në Ferizaj,

Prishtina e Re ka arritur të shkëpusë një pikë si mysafire ndaj Ferizajt, pas barazimit 1:1. Pas këtyre rezultateve, situata në tabelë mbetet e hapur si në pjesën e sipërme ashtu edhe në zonën e mbijetesës. Ferizaj pas këtij barazimi mbetet në vendin e tetë që dërgon në barazh, kurse Prishtina e Re mbetet e fundit, por tani me 28 pikë dhe ende me shpresa për mbijetesë.

### RENDITJA TABELARE NË SUPERLIGË

Drita	54
Ballkani	49
Prishtina	44
Malisheva	43
Gjilani	43
Dukagjini	38
Drenica	35
Ferizaj	33
Llapi	33
Prishtina e Re	28

## ARSIM ABAZI RIKTHEHET NË POZITËN E TRAJNERIT TË FERIZAJT



**FERIZAJ, 20 PRILL** - Arsim Abazi do të jetë në krye të skuadrës së Ferizajt për herën e dytë në këtë sezon të Superligës së Kosovës në futboll. Ferizaj të hënën ka zyrtarizuar Abazin në pozitën e trajnerit, në të cilin ka zëvendësuar Nevil Deden të shkarkuar ditë më parë. Në

njoftimin e Ferizajt, ndër të tjera, është thënë se klubi ka vendosur t'i besojë një figure që e njeh shumë mirë ambientin, filozofinë dhe shpirtin e skuadrës. "Ky rikthim nuk përfaqëson vetëm një ndryshim në pankinë, por edhe një mesazh të qartë për

stabilitet dhe ambicie më të mëdha. Nën drejtimin e tij, pritet që FC Ferizaj të rikthejë identitetin dhe frymën garuese, duke synuar rezultate pozitive në arritjen e objektivave me më shumë siguri dhe motivim", ka njoftuar Ferizaj. Abazi e kishte nisur sezonin si

trajner i Ferizajt për t'u shkarkuar në fund të muajit shtator të vitit të shkuar dhe për t'u zëvendësuar me Nevil Deden. Abazi ishte i papunë prej javës së shkuar kur është shkarkuar nga Dinamo, ekip që bën gara në Ligën e Parë të Kosovës.

## Bayerni fiton titullin e Bundesligës për herë të 35-të në histori

**BAYERN, 20 PRILL** - Bayern Munichu ka siguruar titullin në elitën e futbollit gjerman për herë të 35 në histori, pasi ka përmbyshur rezultatin për të fituar 4-2 në shtëpi ndaj Stuttgartit, që renditet në vendin e katërt në Bundesliga. 15 minutat e para ishin të balancuara, me raste të shpërdoruara nga Kim Min-jae dhe Bilal El Khannouss. Megjithatë, në minutën e 21-të El Khannouss ka asistuar për

Chris Führich, i cili ka shënuar nga një kënd i vështirë për t'i dhënë epërsinë Stuttgartit. Ky gol ka rrezikuar festën e Bayernit, por kampionët kanë reaguuar fuqishëm me tre gola brenda gjashtë minutash. Jamal Musiala ka asistuar për Raphaël Guerreiron, i cili ka barazuar nga afërsia. Më pas, një gabim i Stuttgartit në mesfushë ka lejuar Luis Diazin të asistojë për Nicolas Jacksonin për golin e dytë. Pak

më vonë, Alphonso Davies ka realizuar me një goditje të devijuar për 3-1, duke e mbyllur praktikisht ndeshjen dhe duke vulosur titullin para pushimit. Në pjesën e dytë trajneri Vincent Kompany ka aktivizuar Harry Kanen dhe Michael Olisen dhe Kane ka shënuar vetëm shtatë minuta pas rifillimit për golin e katërt dhe të 32-tin personal në kampionat këtë sezon. Alexander Nübel ka ndalur një

tjetër gol të mundshëm nga Leon Goretzka, ndërsa në fund Chema Andres ka shënuar një gol nderi për Stuttgartin me një goditje të bukur që ka mposhtur Jonas Urbig. Titulli tashmë ishte i sigurt për Bayernin, i cili tani fokusohet te DFB-Pokal dhe Ligën e Kampionëve, duke synuar një sezon me tre trofe. Ndërkohë, Stuttgarti mban ende një epërsi prej dy pikësh ndaj Hoffenheimit në garën për



kualifikim në Ligën e Kampionëve pavarësisht se ka humbur katër nga shtatë ndeshjet e fundit në të gjitha garat. Momentalisht katër xhiro nga fundi, Bayerni ka 79 pikë, ndërsa vendi i dytë, Dortmundi, ka 64 pikë. Ndërkohë, Stuttgarti ka 56 pikë në vendin e katërt.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "AMV PPM PETROL DOO" Leshak, Leposaviq, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunën organizojnë:

### DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për pikën e furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit në Parcelën P-713038079-00293-0 në Z.K. Leshak, Komuna Leposaviq.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.06.2026 në ora 10:00 në Shkollën Filllore "Stana Baçanin" Leshak, K. Leposaviq, do të organizohet debat publik nga Kompania "AMV PPM PETROL DOO" Leshak, Leposaviq, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/2166524738?pwd=aJtauckjGTWwqBViElFDw68ND03rzD.1>

Meeting ID: 216 652 4738

Passcode: 123123

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë "AMV PPM PETROL DOO" Leshak, Leposaviq, për pajisje me Pëlqim Mjedisor, për pikën e furnizimit me derivate të naftës, benzinës dhe plinit në Parcelën P-713038079-00293-0 në Z.K. Leshak, Komuna Leposaviq.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

[vnm.komente@rks-gov.net](mailto:vnm.komente@rks-gov.net)

**Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.**

	<b>Kuvendi Komunal Malishevë Drejtoria Komunale e Arsimit</b>	
	<b>Gjimnazi "Hamdi Berisha" Malishevë</b>	

### ANULON FTESËN PËR OFERTË PËR EKSKURSION

Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë njofton anulimin e Ftesës për Ofertë për organizimin e ekskursionit, e shpallur më 15 prill 2026 në media dhe në njoftimin zyrtar të shkollës.

Arsyeja e këtij anulimi është moskonstituimi i Këshillit Drejtues të Shkollës (KDSH), si dhe disa çështje të tjera teknike.

Ky vendim është marrë pas kërkesës së Drejtorisë për Arsim të Komunës së Malishevës, të datës 16 prill 2026.

Për procedurat e mëtejshme, do të njoftoheni përmes shpalljeve zyrtare dhe mjeteve të informimit publik.

**Malishevë, 20 prill 2026.**

**U.D. Drejtori i Gjinnazit "Hamdi Berisha", Aziz Mazreku, Malishevë**

Gjimnazi "Hamdi Berisha" në Malishevë me datë 15 prill kishte shpallur ftesë për ofertë për zgjedhjen e agjencionit të udhëtimit për organizimin e Ekskursionit në Republikën e Shqipërisë me maturantë për vitin shkollor 2025/2026, me numër të protokollit.: 64/26, duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHT) Nr.02/2016 për aktivitetet jashtë shkollore. Hapja e ofertave sipas shpalljes është dashtë të bëhet me datë; 21.04.2026.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Haki Ibrahim shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Nafije Krasniqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Andi Firzi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK "11 marsi" Prizren.

- Francez Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Zef Lush Marku" Velezhe.

- Kristijan Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IXshfmu " Zef Lush Marku" Velezhe.

- Mensur Morina shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Kreshnik Berisha B.I. Rogovë Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 812216259 të lëshuar nga ARBK.

- Aida Murselaj Çiflak Rahovec shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit "Fehmi Agani" Gjakovë me numër 200102037.

- Muharrem Miftari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Silvira Tomazini" gjimnazi "Frang Bardhi" Mitrovicë.

- Safet I. Mehana B.I shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër unik identifikues: 811313220.

- Rilind Sope shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Mergin Lutfi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Festim Morina shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Hetem Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës "Trimi" SH.P.K. gjatë orarit të punës. Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik e radiotelevizionit të shkollës "Gjin Gazulli" Prishtinë.

- Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Kuvendi i Juniku" Junik.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



**MEKA**  
®  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

